



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË HAPJEN E KURSIT TË TRAJNIMIT PËR DIVERSITETIN STRATEGJIK PËR POLICINË

18 qershor 2012

Zëvendësministri Peka,
Drejtori i Përgjithshëm Burgaj,
Të nderuar të ftuar,

Si Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam shumë i kënaqur që jam këtu me ju sot, duke hapur seminarin e parë mbi Diversitetin Strategjik për drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit shqiptar.

Ky trajnim është një tjetër shembull i mirë i bashkëpunimit të shkëlqyer midis Policisë së Shtetit dhe Prezencës së OSBE-së.

Gjithashtu, do të doja të falënderoja Kolegjin skocez të Policisë për mbështetjen e tij duke siguruar ekspertizën për këtë aktivitet.

Nevoja për respektimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit nga institucionet publike ekziston dhe duhet të jetë e qartë për të gjithë.

Sa i përket OSBE-së, qëllimi ynë është të ndihmojmë për t'i reduktuar të gjitha format e diskriminimit në zero.

Prandaj edhe jemi të gjithë sot këtu – për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar pranimin e diversitetit.

Diversiteti dhe pranimi i tij masin cilësinë demokratike të një shoqërie.

Diversiteti është dhe duhet t'i bëhet i ditur dhe i rëndësishëm për institucionet dhe organizatat publike.

Diversiteti ka të bëjë me pranimin e të qenit unik të çdo individi, dhe të gjithë individët përbëjnë shoqërinë më të gjerë.

Diversiteti formon një pjesë të atij parimi gjerësisht të njohur demokratik se të gjithë qeniet njerëzore, pavarësisht racës, ngjyrës, besimit, etnisë, gjinisë, orientimit seksual apo shkaqeve të tjera, mund të japin një kontribut aktiv dhe pozitiv në shoqëri.

Është çështje e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe barazisë.

Shoqëri evropiane moderne janë ato shoqëri, ku çdo individi i sigurohen mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tij apo të saj.

Shkrimtarja e famshme afrikane Maya Angelou ka thënë: “Ne të gjithë duhet të dimë se diversiteti ndihmon për të pasur një qilim të bukur dhe ne duhet të kuptojmë se të gjitha fjetet e këtij qilimi janë të barabarta për nga vlera, pavarësisht ngjyrës së tyre.

OSBE-ja gëzon angazhimin e plotë të 56 Shteteve anëtare, nga Vankuveri në Vladivostok, për të promovuar së bashku tolerancën dhe mosdiskriminimin, duke ruajtur diversitetin si një vlerë të përbashkët.

Duhet të theksoj moton e duhur, *Të Bashkuar në Diversitet* zgjedhur nga Republika e Shqipërisë për Kryesinë e saj të Këshillit të Evropës, të cilën ne e mbështesim plotësisht.

Ky angazhim lidhet, gjithashtu, edhe me stabilitetin dhe sigurinë.

Diskriminimi i minoriteteve fetare, etnike apo kombëtare është një recetë për të pasur trazira civile, mungesë stabiliteti dhe konflikt.

Prandaj, rëndësia e të luftuari të të gjitha tipave të diskriminimit, duke përfshirë këtu diskriminimin ndaj minoriteteve kombëtare, duhet ketë interes parësor për të gjithë ne.

Është e rëndësishme që policia të përdorë fuqitë ligjore që ka për të luftuar aktet e motivuara nga racizmi ose/dhe ksenofobia.

Garantimi i mbrojtjes së barabartë për të gjithë njerëzit përpara ligjit gjithashtu e pengon policinë të diskriminojë çdo person në bazë race, ngjyre, gjinie, orientimi seksual, feje, gjuhe, opinioni politik, origjine kombëtare, prone apo lindjeje.

Në veçanti për çështjen e komunitetit të Lesbikeve, Gejve, Biseksualëve, dhe Transgjinatorëve, unë do të doja të nënvizoja nevojën për të sensibilizuar Policinë e Shtetit për të gjitha të drejtat e njerëzve që i përkasin komunitetit LGBT.

Unë do të inkurajoja drejtuesit e Policisë së Shtetit të përkrahin sjelljen jodiskriminuese përgjatë të gjitha niveleve të shërbimit dhe të sigurojnë se merren masa për të gjitha rastet e trajtimit joprofesional të njerëzve që i përkasin komunitetit LGBT qoftë brenda radhëve të tyre qoftë nga jashtë.

Policimi diskriminues ka si efekt kriminalizimin e komuniteteve të tëra dhe mohimin e drejtësisë për to.

Komunitetet e minoriteteve shpesh bëhen viktime, në mënyrë jo përpjesëtimore, të krimeve të urrejtjes racore dhe etnike dhe të diskriminimit.

Mungesa e një përgjigjeje të përshtatshme nga ana e Policisë së Shtetit ka rrezikun potencial të krijojë një klimë mosndëshkueshmërie, e cila nga ana e saj mund të kontribuojë në thellimin e perceptimit të marginalizimit dhe përjashtimit social për këta grupe.

Do të sugjeroja që një hap i rëndësishëm për të fituar besimin e komuniteteve minoritare është që ata të integrohen në polici, në të gjitha nivelet.

Integrimi i tyre do të shërbente si masë për ndërtimin e besimit dhe gjithashtu për t'i dhënë policisë një diapazon të gjerë njohurish dhe aftësish që nevojiten për të punuar në një ambient multikulturor.

Të gjitha politikat e rekrutimit në polici duhet pra të sigurojnë përfshirjen e përshtatshme të grave dhe minoriteteve kombëtare.

Miq të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,

Dua të nënvizoj fuqimisht që nuk bëhet fjalë vetëm të trajtohet kjo çështje për të ndihmuar më tej Shqipërinë në rrugën e saj drejt integritimit evropian dhe që ajo të përmbushë detyrimet ndërkombëtare dhe aspiratat kombëtare.

Ky është gjithashtu një investim për potencialin e plotë të qytetarëve të këtij vendi.

Shpresoj se trajnimi që na ka bashkuar sot këtu nuk do të jetë vetëm një përpjekje e izoluar, por një hap në objektivat strategjike të Policisë së Shtetit.

Së fundi, ju uroj të gjithëve një seminar të suksesshëm dhe produktiv.

Ju faleminderit!